



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

PLANI

I

INTEGRITETIT

PËR AUTORITETIN KOMBËTAR  
TË USHQIMIT

VITI 2024

PLANI I INTEGRITETIT TË AKU

## HYRJE

Plani i Integritetit për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (*këtu e në vijim, referuar si "AKU"*), u hartua gjatë periudhës Qershor 2024. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për institucionet e varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (*këtu e në vijim, referuar si "MBZHR"*).

Qëllimi i Planit të Integritetit është vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat kompromentojnë kapacitetet e AKU-së për të realizuar objektivat dhe shërbimin publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme në sistemin dhe fushat që AKU mbulon.

Për të patur një administratë publike profesionale me etikë, integritet dhe të angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve në fushat që AKU mbulon, është domosdoshmëri forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike të anti-korrupsionit.

**Grupi i Punës** i ngritur për hartimin e Planit të Integritetit në AKU, në zbatim të Urdhrit Nr.1733 Prot., datë 20.03.2025 "*Për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit*", i përbërë nga:

1. **Z.Alket Mersini**, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
2. **Z.Alfred Collaku**, Përgjegjës në Sektorin e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
3. **Znj.Alketa Hoxha**, Përgjegjëse në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
4. **Z.Gentian Hysenaj**, Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (*në cilësinë e Strukturës Përgjegjëse për Sinjalizimin*).

Ky Plan Integriteti është hartuar në kuadër të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) me Nr.859, datë 26.12.2024 "*Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës*" dhe është hartuar në referim të dokumentit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për institucionet e varësisë së MBZHR.

**Lista e shkurtesave:**

<b>GRECO</b>	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
<b>MBZHR</b>	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<b>AKU</b>	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

**I. INTEGRITETI NË SISTEMIN E AKU**

Integriteti konsiston transparencën, llogaridhënien, ruajtjen e etikës, efektivitetit dhe efikasitetit, përmirësimin e performancës së Administratës Publike dhe zvogëlimin e niveleve të korrupsionit.

AKU përballlet me risqe integriteti të ndryshme, të cilat pengojnë realizimin e objektivave programore apo operacionale të Institucionit. Në këtë kuadër, procesi i menaxhimit të riskut të integritetit është një proces nëpërmjet të cilit institucioni adreson në mënyrë periodike risqet e integritetit për proceset e punës/aktivitetet (*sipas funksioneve*), me qëllimin final forcimin e ekzistencës institucionale ndaj “riskut të integritetit” dhe zvogëlimin e niveleve të tij.

**1.1. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT**

*Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në AKU konsistoi në zbatimin e fazave të mëposhtme:*

**1.1.1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe mbështetja e stafit të AKU përgjatë procesit**

AKU ngriti grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e Planit të Integritetit të AKU. Në përbërje të grupit të punës janë punonjës të nivelit drejtues (kategoria e mesme dhe e ulët drejtuese). Grupi i punës u kryesua nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, i cili siguroi mbarëvajtjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve në institucion.

**1.1.2. Identifikimi dhe analiza e riskut**

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përfshiu analizën e raporteve të ndryshme të AKU, përfshirë edhe raportet nga auditet e ndryshme nga Autoritetet Kompetente, mbi veprimtarinë e saj por dhe të jashtme mbi çështje që lidhen me fushat e veprimtarisë së AKU.

### **1.1.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Grupi i punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritet të mbështesin ose rrisin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin efektiv të masave ekzistuese të kontrollit apo kontrolleve shtesë në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre.

### **1.1.4. Plani i veprimit për Menaxhimin e Riskut**

Grupi i punës hartoi Planin e Veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion në të cilin u evidentua: risku, kontrollet e ndërmarra, veprimet për të adresuar boshllëqet, zotëruesi i riskut dhe përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre. Zbatimi i Planit të Integritetit është parashikuar për periudhën 2024.

## **1.2. INTEGRITETI DHE SHKELJA E INTEGRITETIT**

Integriteti përbën një standard të nevojshëm për funksionimin e një sistemi menaxhimi në një institucion publik, i cili mbështetet në vlerësimin e riskut të integritetit dhe konkretisht:

- Përvetësimi, shpërdorimi, keqmenaxhimi / devijimi i fondeve publike;
- Trajtimi i qytetarëve / klientëve në mënyrë të pabarabartë apo të padrejtë;
- Kërkesat dhe procedurat e tepërta administrative;
- Mosrespektimi i procedurave / respektimi i kërkesave ligjore;
- Neglizhenca.

Zbatimi në nivel institucional i një plani masash antikorrupsioni për adresimin e risqeve të integritetit, ka për qëllim kryesor përmirësimin e efikasitetit, efikasitetit, efikasitetit, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucionit, si dhe rritjen e besueshmërisë publike në qeverisje.

### **1.2.1. Menaxhimi i risqeve të integritetit në AKU**

Menaxhimi i riskut të integritetit është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik, i cili adreson risqet, rregullatorët, organizativën dhe praktikën e integritetit që i përkasin të shkuarës institucionale, situatës aktuale, por dhe të ardhmes së veprimtarisë së institucionit publik.

Fushëveprimi i vlerësimit të riskut është fleksibël, pasi:

- i. vlerësimi i riskut dhe plani i integritetit është bërë për AKU-në referuar metodologjisë së punës lidhur me shërbimet ose detyrat institucionale;
- ii. vlerësimi i riskut përqëndrohet në çdo funksion specifik administrativ.

Në këtë kuadër, sistemi për menaxhimin e integritetit është një instrument i gjurmueshëm për parandalimin e korrupsionit në AKU. Në mënyrë që të kemi një sistem funksional të menaxhimit të integritetit, do të miratojmë dhe zbatojmë një kuadër për përmirësim të vazhdueshëm të integritetit si dhe do të instalojmë procesin e menaxhimit të integritetit si kulturë pune në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të AKU-së. Pra, në përmbledhje, institucioni:

- i. do të miratojë dhe zbatojë politika pro-integritetit, të tilla si planet e punës;
- ii. do të mbikqyrë dhe vlerësojë realizimin e aktiviteteve të institucionit në lidhje me parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit, kundrejt përmbushjes së objektivave institucionale të integritetit dhe politikave 'pro-integritet' të miratuara për këtë qëllim. Rezultatet e vlerësimit do t'i raportohen titullarit të institucionit;
- iii. do të kryejë vazhdimisht aktivitete që lidhen me përmirësimin dhe forcimin e integritetit të institucionit dhe sistemit të menaxhimit të integritetit.

### **1.3. PLANI I INTEGRITETIT**

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operativ, i cili mbështetet në rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit për të gjitha aktivitetet dhe detyrat institucionale.

Plani i Integritetit i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve që çenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të.

Plani i Integritetit është një proces i dokumentuar që vlerëson nivelin e cënueshmërisë së një institucioni dhe ekspozimin e tij ndaj korrupsionit dhe praktikave joetike dhe joprofesionale.

Plani i Integritetit do të ofrojë kornizën konceptuale mbi politikat dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të zyrtarëve dhe punonjësve publikë, si dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik, në zbatim të VKM-së Nr.859, datë 26.12.2024 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës”. Gjithashtu, Plani i Integritetit është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

### **1.3.1. Qëllimi i Planit të Integritetit**

Plani i Integritetit do t’i shërbejë AKU-së, në:

- përmirësimin e një sistemi menaxhimi efektiv të integritetit në institucion, që synon sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore, procedurale, kuadrit të brendshëm rregullator, si dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Ky sistem do të jetë funksional nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve njerëzore të institucionit në të gjitha nivelet për antikorrupsion efektiv, për zhvillimin e zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit, për të gjithë punonjësit e institucionit;
- forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisje dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- forcimin e ekzistencës ose qënies institucionale ndaj çënimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operationale në fushat e funksionit të institucionit dhe proceset e punës me risk korrupsioni;
- planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit në institucion, me fokus në fushat e funksionit të institucionit me risk më të lartë të çënimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

### **1.4. PARIMET E VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT PËR AKU**

Referuar Metodologjisë, parimet e vlerësimit të riskut përfshijnë:

- minimizimin e pushtetit diskrecional të tepërt dhe të panevojshëm që zotërojnë autoritetet ekzekutive, administrata apo organet/strukturate në marrjen e një vendimi dhe/ose qartësimin e caktimit të kritereve, procedurave dhe standardeve për procesin e vendimmarrjes;

- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike institucionale lidhur me aktivitetin që kryen, gjë që minimizon risqet që dëmtojnë integritetin e institucionit dhe është garanci për zbatimin e parimit të ligjshmërisë;
- forcimin e mekanizmave të kontrollit për institucionin. Në parim, çdo veprim i autoritetit publik duhet të jetë objekt kontrolli për të ruajtur sistemin ‘kontroll-balancë’ dhe parimin e ndarjes së pushteteve;
- thjeshtëzimin dhe riorganizimin e procedurave të zbatuara nga autoritetet, organet apo administrata qendrore të cilat nuk përmbushin qëllimin për të cilin janë miratuar dhe krijojnë mundësi për risqe integriteti.

## II. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT

*Në lidhje me risqet dhe faktorët e tjerë të lidhura me integritetin*, aktualisht AKU ka hartuar dhe miratuar një numër dokumentash strategjike institucionale për aspekte të integritetit, të tilla si: Kodi i Etikës, Rregullore për parandalimin e konfliktit të Interesave, Rregullore për sinjalizuesin, etj. Këto dokumenta janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.

*Në lidhje me risqet dhe faktorët e risqeve të lidhura me burimet njerëzore në institucion (burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme)*, në manualin e proceseve të punës, mirëfunksionimi i administratës ka nevojë për linja të qarta hierarkike, manuale të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit (të cilat ndryshe quhen “Procedura Standarde Veprimi”) në të cilin janë pasqyruar gjurmët e veprimeve, planet vjetore të punës, si dhe promovimi dhe përqafimi i standardeve dhe parimeve të administratës publike.

*Në lidhje me plotësimin e strukturës/organikës*, AKU ka një organikë të miratuar me 433 (katërqind e tridhjetë e tre) punonjës nga të cilët 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) janë punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU ndërsa 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) punonjës të tjerë pranë Drejtorive Rajonale të AKU, marrëdhëniet e punësimit të të cilëve janë të rregullura sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Institucioni ka ngritur Njësinë e Sinjalizimit brenda Drejtorisë së Përgjithshme. Nga vlerësimi i situatës, rezulton një reflektim i kufizuar i burimeve njerëzore nisur nga fluksi dhe natyra specifike institucionale.

*Në kuadrin e brendshëm rregullator*, strukturat institucionale antikorrupsion dhe ato të ndërtimit të integritetit në AKU, janë si vijon:

- Struktura e Sinjalizimit (*funksionon me dy punonjës*);
- Koordinatorin për të Drejtën e Informimit (*funksionon me një punonjës*);
- Njësia Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (*funksionon me një punonjës*).

Gjithashtu, vlen të theksojmë se AKU funksionon sipas rregullave të BE (kapitulli 12) dhe është një Institucion me një natyrë shumë specifike e teknike pune për të cilën ka hartur manualët e brendshme institucionale të operimit të cilat gjurmojnë gjithë proceset e punës në AKU, çka do të thotë se çdo proces pune është i gjurmueshëm, i kodifikuar duke shmangur kështu korrupsionin.

*Në lidhje me trajnimin e stafit*, si një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të burimeve njerëzore në institucion, është trajnimi i vazhdueshëm i tyre. Nga vlerësimi i situatës, rezulton mangësi e trajnimeve teknike të punonjësve për arsye të mungesës së buxhetit. Zgjidhja e AKU për këto raste kanë qenë kërkesat drejtuar projekteve të ndryshme që operojnë në fushën e veprimtarisë së AKU dhe një pjesë e tyre janë siguruar në këtë mënyrë. Për të patur qëndrueshmëri, nevojitet që çdo vit, AKU-së t'i akordohen fonde për ruajtjen e kompetencës teknike apo për zgjerimin e njohurive referuar sfidave institucionale.

*Në lidhje me risqet dhe faktorët e risqeve për transparencën e punës dhe veprimtarinë brenda institucionit me aktorët e jashtëm të interesuar dhe me publikun, për sa i përket publikimit të informacioneve apo dokumentave të ndryshme*, nga analiza e faqes zyrtare të web-it të AKU, konstatohet se publikohen rregullisht të dhëna dhe informacione të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë këtu: Raporte KLSH, auditime të ndryshme, etj.,

Ndërsa, *për sa i përket komunikimit të brendshëm*, Koordinatorin për të drejtën e Informimit është caktuar me akt të Titullarit dhe të dhënat e tij janë të publikuara në faqen zyrtare të AKU.

Nga ana tjetër, transparenca e veprimtarisë së institucionit kushtëzohet shumë nga komunikimi efektiv i brendshëm ndërmjet Drejtorive dhe Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit kërkon jo vetëm staf të informuar dhe me aftësitë e duhura, por edhe komunikim efektiv që respekton afatet kohore në sigurimin e informacionit. Për më tepër, koordinimi dhe komunikimi i brendshëm ndërmjet Drejtorive dhe Koordinatorit është i një rëndësie të veçantë edhe në aspektin e përmbushjes së objektivave të këtij Plani.



### III. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të Integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së AKU. Ai është një pjesë plotësuese e politikave dhe kornizës rregullore për përmirësimin dhe forcimin e Integritetit Institucional.

Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integriteti si më poshtë:

1. Procese dhe rregulla mbi aspekte të Integritetit në AKU në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit;
2. Burime njerëzore adequate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit;
3. Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimatrisë së AKU, brenda institucionit, me aktorët e jashtëm të interesuar dhe publikun.

#### 3.1. Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit

Monitorimi i Planit të Veprimit është periodik (*çdo vit*) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara dhe Planin e Veprimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qënë eficente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të Institucionit apo ndryshime të vet risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (Planit të Veprimit) si dhe nxjerrjen e mësimeve për planifikimin më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të Integritetit për risqet e Integritetit sipas afateve kohore të parashikuara.

Ky proces ndiqet nga personat përgjegjës të caktuar nga titullari i AKU, të cilët monitorojnë progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe 6 (*gjashhtë*) mujore. Raportimi i lejon titullarit për të marrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

### **3.2. Plani i Veprimit**

Plani i Veprimit të AKU-së për zbatimin e Planit të Integritetit, referuar objektivave e aktiviteteve të parashikuara për minimizimin e risqeve të integritetit dhe faktorët e risqeve, kategorinë e faktorëve të riskut, nivelit të prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar ose i ulët, sipas afateve kohore dhe me strukturat përgjegjëse me aktivitetet e parashikuara, jepet sipas anekseve bashkëlidhur këtij Raporti, si vijon:

- Objektivi 1:** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MBZHR dhe institucioneve në varësi të saj.
- Objektivi 2:** Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga strukturat përkatëse.
- Objektivi 3:** Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve.
- Objektivi 4:** Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKU.

Objekti Nr. 1: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, si dhe bashkëpunimi i punës me MBZHR me qëllim rritjen e financimeve nga donatorët për AKU.

Plani i integritetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit							
Nr.	Risiku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	Realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito afate nëse ka të tilla)
1.1	Mos ardhja në kohë e udhëzimeve nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Përpunuesit	I moderuar	Mbajja e vazhdueshme e kontakteve me MBZHR dhe me Drejtorinë e Planifikimit Financiar në Ministrinë e Juces	Drejtori i AKU -se dhe P/S/Buxheti dhe Menaxhimi Financiar	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Realizuar. Kanë ardhur aktet në afatet e paracaktuara dhe nga AKU janë realizuar parashikimet në PBA 2025-2027 sipas akteve ligjore.
1.2	Mos mbërtitja në kohë dhe me cilësi e informacionit ndaj nevojat për fonde nga strukturat e AKU-se në Drejtorinë e Përgjithshme dhe si dhe nevojat për fonde nga Drejtoritë Rajonale të AKU-se.	Përpunuesit	I moderuar	Mbajja në kontakt të vazhdueshëm dhe këshillimi i stafit të drejtorive me qëllim përmirësimit të cilësisë së planifikimit.	Nga Drejtoritë përkatëse që lind nevoja për financim	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Realizuar. Janë marrë zyrtarisht kërkesat për financime nga Drejtoritë dhe Sektorët përkatës. Janë dorëzuar pranë Sektorit të Shërbimeve të Brendshme dhe Prokurimeve dhe Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Theksojmë se 2 herë në vit në bashkëpunim me drejtoritë bëhen planifimi i kërkesave të PBA-së në të cilën parashikojnë nevojat tonë.
1.3	Moskordinimi i plotë i fondeve buxhetore të kërkuara për sipërzimime operative dhe investimet, si dhe miratimi me vonesë i plan buxhetit sipas zërave nga MBZHR për Drejtoritë e AKU-se dhe Drejtorinë e Përgjithshme	Financiar	I moderuar	Argumentimi sa më i plotë teknik dhe ligjor i nevojave për fonde.	MBZHR (GMS E PROGRAMIT TE SIGURISE USHQRIMORE) e cila na akordon fonde buxhetore për sipërzimime kapitiale dhe operative për mbulimin e nevojave të AKU	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Në fund të cdo viti AKU dërgon nevojat për buxhet për vitin pasardhës ndaj nevojat. Idhurat me Investime dhe sipërzimime operative. Ministria miraton buxhetet sipas prioritetëve lidhur me politikat e saj strategjike, planet e miratuarat vijin me vonesë. Nderkohë që duhet të vijin të miratuarat dhe shlogëtuara me buxhetin përkatës. Ka problematika në dërgimin e këtyre planeve në kohën e dalur nga MBZHR
1.4	Zhvillime të reja lidhur me politikën e qeverisë për inspektimin në tregësi me ndikim në Kontrollin e Inspektimit e sigurisë ushqimore	Përpunuesit	I moderuar	Risikimi i prioritetëve në fushën e sigurisë ushqimore (intensifikimi i kontrolleve zyrtare dhe inspektiveve)	Struktura e AKU-se në Drejtorinë e Përgjithshme	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Ndërmarrja e veprimeve për një menaxhim sa më efektiv të burimeve të brendshme financiare në dispozicion si dhe intensifikimi i kontrolleve zyrtare dhe inspektiveve
1.5	Mosrealizimi në kohë, i procedurave elektronike të prokurimit të fondeve buxhetore (për sipërzimime operative dhe blerjet me vlerë të vogël) për arsye të procedurave të reja dhe mosparaditjes së operatorëve ekonomikë.	Operacional	I moderuar	Pjesëmarrja në trajnime e punonjësve që merren me procedurat e prokurimit kjo në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.	Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme. (Sektorit prokurimeve) në Drejtorinë e Përgjithshme AKU	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Janë kryer procedurat sipas regjistrat të prokurimeve për vitin 2024.
1.6	Hartimi me një cilësi të dobët i Termave të Referencës	Operacional	I moderuar	Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e standardeve të projektimit	Drejtoritë e AKU	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Janë konsideruar nga drejtoritë përmirësimet sipas rasteve të termave të referencës në bazë të eksperimentit.
1.7	Vonesat e procedurave të prokurimit.	Operacional	I lartë	Ndjekja e afatëve të procedurimit sipas legjislativitetit.	Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme	6 M 1 2024 6 M 2 2024	Procedurat e Prokurimit kanë vonesat përkatëse, kjo e lidhur ngushtësisht me procedurat e vendimtarëve që ndjek KPP në varësi të ankësive të operatorëve ekonomikë. Nuk ka patur vonesa në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

**Objektivi Nr. 2: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të akteve nga struktura përkatëse.**

Plani i integritetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Nr.	Riska dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitete që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1.1	Riska A	Sigurimi i bashkëpunimit me drejtoritë teknike lidhur me kuptueshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore		<p>Bashkëpunimi me drejtoritë teknike në Ministri është i rëndësishëm së lartë sidomos në rastet kur Ligje/Urdehëzime/Regullat apo akte rëndësi të paraqiten komplekse apo përmbajtje një sërë parashikimesh rregullator në varësi të objektit të rregullimit.</p> <p>Për të siguruar që personeli nuk keqkupton ose nuk arrin të kaptoj një tekst ku ndonjëherë, fjalët kanë kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit rregullator ndaj bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse në Ministri është vendimtar jo vetëm që akti ligjor të jetë i kuptueshëm por edhe të garantohet zbatimin sa më eficient të tij.</p>	Drejtoritë teknike të MBZHJ dhe Drejtoritë teknike të AKU	Në vijim	<p>Po ka bashkëpunim ndërmjet palëve sa herë del një akt ligjor dhe menjëherë i ri ku përshihet AKU. Në vijim të zbatimit të masës së parashikuar në kohën e paraqitjes së një detyre të përbashkët, akti, kërkesë, etj. kryen takime me specialistët e fushës konkrete që preket diskutohet merret mendimi i ekspertit etj. Në rastet kur kërkohej të bashkëpunohet me institucione të tjera dhe përparohet informacioni.</p>
	Bashkëpunimi me drejtoritë teknike në garantimin e kuptueshmërisë të tekstit ligjor të akteve ligjore.	Përpunshmëri	I lartë				

### Objektivi Nr. 3: Sigurimi i efijencës në kryerjen e kontrollleve zyrtare

Plani i integritetit të Institutit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit							
Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: I lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	Realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1	Certifikimi i produkteve ushqimore për eksport (vezë peshk) nga një inspektor i veçëm	Operacional	I lartë	Domosdoshmëria e kryerjes së certifikimeve nga dy inspektorë	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Kordinimit të Kontrollit Zyrtar, Drejtoritë Rajonale të AKU	Në vijimësi	Procedura e certifikimit të produkteve për eksport të kryhet nga drejtoritë rajonale nëpërmjet një procesi të rregullt inspektiv, me nxjerrjen e autorizimit për dy ose më shumë inspektorë
2	Shmangia e subjektivizimit të inspektorëve në kontrollin zyrtar në kuadër të licensimit e OBU	Operacional	I mesëm	Përmirësimi dhe vendosja e kriterëve objektivë dhe të matshme në listë verifikimit e procedurave të licensimit	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Kordinimit të Kontrollit Zyrtar, Drejtoritë Rajonale të AKU	Në vijimësi	Miratuar (listë verifikimit) sipas kriterëve të licensimit sipas kategorive dhe kërkesave specifike për procedurën e licensimit

## Objektivi Nr. 4: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKU

Plani i integritetit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

Nr. Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktivitetëve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1 Mosrealizimi në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të punës	Operacional	I mesëm	Plotësimi i numrit të stafit	Drejtoritë Përkrahëse të AKU	6-mujori i rë i 2024	Realizuar në përqindjen më të madhe të punës, për vetë natyrën teknike dhe urgjente që ka AKU në lidhje me menaxhimin e stafit, rekrutimit, administrimit të marrëdhënieve të punës dhe trajtimin të kërkesave ligjore. Përmes planifikimit të mirëorganizuar, ndjekjes së ataleve dhe plotësimit e angazhimit të stafit të sektorit, është arritur realizimi në kohë i proceseve kyçe, duke shmanjur kështu vonesat dhe duke garantuar zbatimin e procedurave sipas standarteve ligjore e operacionale.
2 Personeli i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të pëmbushur proceset e rëndësishme	Operacional	I mesëm	Ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Aktiv-Protokollit	Sektorin e Burimeve Njerëzore, Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme	6-mujori i II-të i 2024	Struktura e AKU-së funksionon me Urdhër të Kryeministrit Nr.128, datë 26.10.202. Kjo strukturë e cila ndër vite ka patur mangësi të plotësimit të vendeve vakante, tashmë është plotësuar dhe funksionon në mënyrë optimale, duke garantuar menaxhimin më të regullit dhe efikas të proceseve, përmirësimin në organizimin e punës dhe përmirësimin e detyrave brenda atëvareve ligjore.
3 Mosreflektimi në kuadrin e brendshëm regullator të rregullave për dorëzimin e detyrës nga punonjësit në rastin e largimit nga detyra	Operacional	I lartë	Përshtetja e rregullave në Rregulloren e Brendshme të AKU	Drejtorin e Shërbimeve të Brendshme	6-mujori i rë i 2024	Realizuar. Në rastet e largimeve të punëmarësve nga puna, janë ndjekur dispozitat e parashikuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë si dhe Rregullat Institucionale.